



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:070678
Datë: 03.06.2021
Numri i dokumentit: 01847404

P.nr.1167/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. K. nga Prishtina për shkak të dy veprave penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPRK-ës duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.2021/2018 të datës 18.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, me datë 28.05.2021 mori dhe shpalli ndërsa me datë 03.06.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari A. K., nga babai M. dhe nëna Gj., e lindur B., i lindur me datë 31.10.1965 ne fshatin Leskovec, Komuna e Prizrenit ndërsa me vendbanim në Prishtinë rruga “Shaqir Igrishta 2/2”, numër, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar ne furrën e bukës “Tanore” në rrugën B në Prishtinë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me datë 02.07.2018, rreth orës 14:00 h në Gjilan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete e mashtron personin tjetër-të dëmtuarin M. R. në atë mënyrë që i shkon në firmën e tij “.....” dhe merr me qira për dy ditë automjetin e markës “Mercedes”, tipi “A-Class”, ngjyrë e kaltër, me targa të regjistrimit 06-219-CC të cilën automjet nuk e kthen por e shet në Fushë Kosovë.

-Me çka ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës.

II.

Me datë 31.07.2018 rreth orës 15:05 minuta në Gjilan, në rrugën “Lidhja e Prizrenit” me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete e mashtron personin tjetër-të dëmtuarin B. S. në atë mënyrë që shkon tek kioska “.....”, kërkon një pako cigare “Marlboro” dhe ia jep paratë në vlerë prej 100 € dhe në momentin kur i dëmtuari ia kthen kusurin i akuzuari kërkon që t’ia kthen sërish 100 € se kinse ka para të imta për t’ia paguar cigaret dhe gjatë ndërrimit të parave arrin që ta mashtrroj të dëmtuarin duke ia marrë edhe 50 € të tjera dhe më pas largohet nga aty.

-Me çka ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,45,46,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës¹ dhe neneve 248, 326 dhe 365 të KPP-ës, akuzuarit të lartcekur:

I CAKTON

Për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro) dhe dënim burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve ndërsa

Për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve.

Ndërsa në bazë të nenit 80 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 dhe 2.4 të KPRK-ës të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

ME DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej 7 (shatë) muajve dhe DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 600 € (gjashtëqind euro) të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Obligohet i akuzuarit që në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit B. S. t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 50 € (pesëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ndërsa i dëmtuari M. R. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil meqenëse gjykata në raport me këtë të dëmtuar nuk pati prova të mjaftueshme të cilat paraqesin bazë të sigurt për gjykimin e kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 100 € (njëqind euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 18.12.2018 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.2021/2018 kundër të akuzuarit A. K. nga Prishtina për shkak të dy veprave penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-së.

Më datë 18.06.2020 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i akuzuari A. K. Në këtë seancë pas leximit të pikës I dhe II të dispozitivit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari i lartcekur ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale nga pika II e dispozitivit të aktakuzës ndërsa nuk e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale nga pika I e dispozitivit të aktakuzës, me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit për veprën penale

¹ Ndaj të akuzuarit të lartcekur është zbatuar ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale përkatësisht KPRK numër 04/L-082 i cili njëherit është edhe më i favorshëm për të akuzuarin në raport me KPRK numër 04/L-074 i cili është në fuqi tani.

nga pika II e dispozitivi të aktakuzës përkatësisht mashtrimit nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës ndërsa sa i përket veprës penale nga pika I e dispozitivit të aktakuzës lëndore i njejtë është njoftuar se mund të paraqes kërkesën për hedhjen e aktakuzës si dhe kundërshtimin e provave gjë të cilën i njejtë nuk e ka shfrytëzuar me ç' rast me krijimin e kushteve ligjore gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor për datë 26.05.2021 në të cilën seancë i akuzuari pas leximit të pikës I të dispozitivit të aktakuzës lëndore i ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilat akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 326 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit edhe për këtë vepër penale dhe më pas seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar me fjalët përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale që ia vë në barrë aktakuza si përfaqësues i akuzës mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe propozimeve që e njëjta i përmban dhe i propozon gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritore duke i pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në lartësinë e dënimit.

I akuzuari A. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vie shume keq për rastin që ka ndodhur, i kërkon falje të dëmtuarve dhe është në gjendje që tua kompensoj dëmin në tërësi pas vuajtjes së dënimit në të cilin gjendet, premtori që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, po ashtu i vie shumë keq për B. pasi që e njeh dhe dëshiron që t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar andaj kërkon nga ana e gjykatës që ti shqiptohet një dënim sa më i butë, po ashtu kërkon nga ana e gjykatës që nëse është e mundur ti shqiptohet një dënim me burgim i cili mund të zëvendësohet në dënim me gjobë pasi për një gjë të tillë tani i ka kushtet për shkak se nipi i tij e ka një firmë në Itali dhe do të mund ta paguante dënimin dhe lidhur me zëvendësimin e dënimit ky deklarimi i tij të merret si pëlqim për zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar dhe atë gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprat penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 përkatësisht 326 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raportet fillestare të incidentit me numra të rastit 2018-CA-0851 dhe 2018-CA-0989, deklaratat e të dëmtuarëve M. R. dhe B. S., deklaratat e dëshmitarëve B. Zh., raportet e policëve I. R. dhe B. S., raporti i policit I. Sh. vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, vërtetimi m i lirimit e automjetit, vërtetimi mbi kthimin e sendit, CD-ja me video incizim si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i akuzuari A. K. nga Prishtina, ka kryer veprat penale të mashtrimit nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikat I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se i njejt ka qenë plotësisht i përgjegjshëm për veprimet e tija meqenëse i njejt në kohën e kryerjes së veprave penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se i njejt ka paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ti kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor si dhe faktin se i njejt këto vepra i ka kryer me dashje dhe atë direkte, gjykata pati parasysh edhe motivin e kryerjes së këtyre veprave penale i cili del të jetë përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore duke e mashtruar personin tjetër, gjykata pati parasysh edhe intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur ku si pasojë e veprimeve të të akuzuarit të dëmtuarëve u është cenuar masa pasurore, gjykata pati parasysh edhe sjelljen e mëparshme të të akuzuarit ku nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës del se për të akuzuarin nuk është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe se nuk është hera e parë që dyshohet se ka kryer vepra penale të mashtrimit tregues ky për personalitetin e të akuzuarit, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajit nga ana e të akuzuari si dhe rrethanat personale të tij.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tij meqenëse i njejt fajësinë për kryerjen e këtyre veprave e ka bërë në një fazë të hershme të procedurës penale, pendimin e tij të cilin gjykata e mori si pendim të thellë dhe real, keqardhjen e shfaqur nga ana e të akuzuarit, kërkim faljen e tij në drejtim të të dëmtuarëve, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera dhe atë se më nuk do të përsërisë kësi lloj të veprimeve ndaj të dëmtuarës si dhe gatishmërinë e tij për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e veprave penale ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del i akuzuari këto vepra penale i ka kryer me dashje dhe atë direkte sepse i njejt e ka ditur se me veprimet e tij do të shkaktohet pasoja e ndaluar përkatësisht të dëmtuarëve do tu shkaktohet dëm pasuror dhe përkundër kësaj i njejt e ka dëshiruar përkatësisht ka ndërmarrë veprime për shkaktimin e pasojës së ndaluar ashtu siç përshkruhet në pikat I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjithashtu si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e të akuzuarit për kryerjen e veprave penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik e po ashtu edhe nga provat e çështjes del se i njejt ka qenë i vendosur për ti kryer këto vepra gjithnjë duke i mashtruar të dëmtuarit, gjykata si rrethanë rënduese për të akuzuarin mori edhe shkallën e dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprave penale e cila përfshin dëmin pasuror që iu është shkaktuar të dëmtuarëve andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 76 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata vendosi që të akuzuarin ta obligojë që në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit B. S. t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 50 € (pesëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ndërsa i dëmtuari M. R. për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil meqenëse gjykata në raport me këtë të dëmtuar nuk pati prova të mjaftueshme të cilat paraqesin bazë të sigurt për gjykimin e kërkesës pasurore juridike.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 100 € (njëqind euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1167/2018, me datë 03.06.2021

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.